



Lidhja mes të Drejtave të Njeriut dhe Shëndetit

Presented by: **Basri Kastrati**

2023

Lidhja mes të Drejtave të Njeriut dhe Shëndetit

SHËNDETI

A i përket sferës private apo përbën një politikë publike ?

- Zhvillimet e politikave shëndetësore
- Deri në shekullin e 19-të, një çështje private!
- Shekulli XIX – masat e higjienës publike!
- Shekulli XX – nga higjiena publike te shëndeti publik!

Sistemet e mbrojtjes sociale

- ✓ Gjermani - Bismark – 1883
- ✓ Franca - nga viti 1930

Sistemet shëndetësore



Janë një element thelbësor i një sistemi të shëndetshëm dhe shoqërie të barabartë.

Kur shëndeti shihet si një e drejtë e njeriut, kërkohet nga ne që të ndërmarrim veprime dhe përgjegjësi për të mundësuar qasje në sistemin shëndetësor.

E drejta për shëndetin është një instrument ligjor që mund të përdoret për të mbajtur qeveritë dhe komunitetin ndërkombëtar përgjegjës .

Në pika të shkurtra ky edhe është mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit ose Institucioneve për të drejtat e njeriut.

Organizata botërore e Shëndetësisë(OBSH)

- Statuti i OBSH u votua nga Konferenca botërore e Shëndetësisë më 22 korrik 1946.
- Themeluar më 7 prill 1948.
- Seli e përhershme në Gjenevë.

Objektivat e OBSH

- OBSH synon të sjellë të gjithë popujt e botës në nivelin më të lartë të mundshëm të shëndetit.
- Shëndeti është "gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesë e sëmundjes ose dobësisë"

Politikat e OBSH-së



Harmonizimi, kodifikimi: klasifikimi i të gjitha sëmundjeve;

Masat sanitare;

Ndihma për vendet më pak të zhvilluara: vaksinimi kundër sëmundjeve të mëdha infektive, furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i mbetjeve, mbrojtja e nënës dhe çrrënjësja e sëmundjeve të caktuara;

Hulumtimi:

Agjencia Ndërkombëtare për Kërkimin e Kancerit (IARC) në Lion,

Qendra e Zhvillimit të Shëndetit (WKC) në Kobe, Japoni

Një program gjithëpërfshirës për të luftuar SIDA-n;

Të garantojë akses në barna të cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të mirë, falë programit të kontrollit të barnave;

Të ofrojë mbështetje teknike për shtetet anëtare dhe zyrtarët shëndetësorë për të forcuar sistemet shëndetësore për të ofruar shërbime adekuate dhe të barabarta për të gjithë;

Deklarata e Alma-Atës (1978)



Konferenca Ndërkombëtare mbi Kujdesin Parësor Shëndetësor - Alma-Ata, 6-12 shtator 1978.

Deklarata thekson nevojën për veprim urgjent nga të gjitha qeveritë, të gjithë njerëzit në sektorët e shëndetësisë dhe zhvillimit dhe komuniteti ndërkombëtar për të mbrojtur dhe promovuar shëndetin e të gjithë njerëzve në botë.

KARTA E OTAVËS- Promovimi i shëndetit



Miratuar më 21 nëntor 1986 nga Konferenca Ndërkombëtare për Promovimin e Shëndetit, në Otava.

Kushtet për shëndetin:

-Shëndeti kërkon një numër të caktuar parakushtesh dhe burimesh, ku individi duhet të jetë i aftë në veçanti:

Strehim,

Qasje në arsim,

Ushqimin e duhur,

Të ardhura të caktuara

Të jetojë në një ekosistem të qëndrueshëm,

Të mbështetet në një furnizim të qëndrueshëm të burimeve,

Të kenë të drejtë për drejtësi sociale dhe trajtim të drejtë.

Këto janë parakushtet thelbësore për çdo përmirësim të shëndetit.

E drejta e shëndetit në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut



- A. Aktet me rëndësi universale
- B. Konventat e Këshillit të Evropës

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj) është një deklaratë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948

Neni 25

1. Çdo person ka të drejtën për një nivel jetese të mjaftueshëm për të siguruar shëndetin, mirëqenien e tij dhe të familjes, veçanërisht për ushqimin, veshjen, strehimin, trajtimin mjekësor si dhe për shërbimet sociale të nevojshme; ai ka të drejtën për sigurimet shoqërore në rast papunësie, sëmundje, invaliditeti, të vejërisë, pleqërie apo në raste të tjera mungese të mjeteve për të jetuar për shkak rrethanash që nuk varen nga vullneti i tij.
2. Nëna dhe fëmija kanë të drejtën për një ndihmë dhe një asistencë të posaçme. Të gjithë fëmijët, qofshin të lindur në martesë apo jashtë saj, gëzojnë mbrojtje shoqërore të njëjtë.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore



E konsideruar si instrumenti kryesor i mbrojtjes së të drejtës së shëndetit, njeh: “Të drejtën e të gjithëve në gëzimin e standardit më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor.”

Në nenin 12, paragrafi 2.3 në mënyrë që të arrihet realizimi i kësaj të drejte, Konventa i obligon shtetet të ndërmarrin hapa për: “Parandalimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe sëmundjeve të tjera”

Sipas Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara Komenti i Përgjithshëm nr. 14: “Shëndeti është një e drejtë themelore e njeriut e domosdoshme për ushtrimin e të drejtave të tjera të njeriut. Çdo qenie njerëzore ka të drejtë të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit të favorshëm për të jetuar një jetë me dinjitet.”

Kosova, Shëndeti dhe të drejtat e njeriut



Në të kaluarën, mundësitë e Kosovës për të zhvilluar një sistem modern të kujdesit shëndetësor ishin të kufizuara. Sidoqoftë, themelimi i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës shënoi një zhvillim domethënës në kujdesin shëndetësor.

Të drejtat e njeriut janë thelbësore për çdo shoqëri demokratike. Për të arritur këtë nivel është e rëndësishme që qeveria dhe institucionet të vazhdojnë të punojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut, përmirësimin e legjislacionit dhe sidomos në implementimin e tij.

Baza kushtetuese dhe ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit



1

Baza kushtetuese e veprimit të Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: „Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”.

Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafin 3 parasheh: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”

2

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi

“Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.” (neni 16, paragrafi 1);

3

Në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, tek

Neni 4 Të drejtat dhe përgjegjësitë në kujdesin shëndetësor

1. Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.
2. Të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor.

Udhëzimi Administrativ 15/2013 në lidhje me Kartën e të Drejtave dhe përgjegjësisive të Pacientit



Tregon se të drejtat e pacientit janë të drejta të njeriut në kujdesin shëndetësor dhe përfshijnë çështjet ligjore dhe etike në një marrëdhënie profesionist shëndetësor-pacient.

Ndërsa Karta e përgjegjësisive të pacientit tregon se: Nëse e lejon gjendja e tij shëndetësore, qytetari varësisht nga aftësitë dhe njohuritë e tij duhet të bashkëpunojë me profesionistët shëndetësor, të përfshirë në trajtimin mjekësor.

Zbatimi në praktikë



- E drejta e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale hyn në grupin e të drejtave sociale-ekonomike, të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Sfidë mbetet implementimi i tyre si p.sh: Ligji për Sigurimin shëndetësor Ligji Nr. 04/L -249, Prill 2014, i cili ende nuk po gjen zbatim, gjersa Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vazhdon të mos jetë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- IAP në bazë të ankesave dhe të rasteve të hetuara vitin e fundit ka konstatuar se ka mungesa të furnizimeve të rregullta me barna esenciale, produkte e pajisje medicinale si dhe materiale shpenzuese, si dhe kanë vazhduar pritjet e gjata të pacientëve për të kryer disa lloje intervenimesh.
- IAP në fund të dhjetorit 2022, ka adresuar tek autoritetet përgjegjëse raportin për të drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Republikën e Kosovës.
- Ky raport ka gjetur probleme që ka sistemi shëndetësor, si: stafi i pamjaftueshëm mjekësor dhe jo mjaft i përgatitur për t'iu përgjigjur standardeve më të mira për shërbime të dinjitetshme dhe cilësore; mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për shëndetësi, përfshirë mungesën e sigurimeve shëndetësore.
- Gjithashtu shqetësuese ka vazhduar të jetë largimi i profesionistëve shëndetësorë .

Kofi Anan

“Më në fund, shëndeti nuk do të shihet si një avantazh i dëshirueshëm, por një e drejtë themelore për të cilën duhet luftuar”.

Francis W. Peabody

“Trajtimi i një sëmundjeje mund të jetë tërësisht jo personal; kujdesi i një pacienti duhet të jetë plotësisht personal.”

Thank you – Faleminderit